

Date 01/06/2022

STATUTI
I
SHOQËRISE "O2 BOUTIQUE" SHPK

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME
Neni 1

Ne ortaket themelues te shoqërise "O2 BOUTIQUE" SHPK me gjeneralitetet e cituara me poshte :

1-Olsjon Bylyku : i biri Hajriut, lindur ne Maminas me daten 18.04.1998 dhe banues ne Tirane ne adresen : Njesia Bashkiake nr.9, Rruga "Robert Naci", Godine Private 29/1, mbajtes i leternjoftimit me nr. J80418046L.

2-Olger Koleci: i biri i Spiros, lindur ne Korce me daten 08.05.1980 dhe banues ne Korce ne adresen: Lajta 16 Rruga "Viktor Efimiu" ,mbajtes i leternjoftimit me nr. I00508073V.

deklarojme se aktiviteti i shoqërise "O2 BOUTIQUE" SHPK do te organizohet dhe zhvillohet ne baze te ketij statuti dhe kerkesave te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqërite tregtare".

Neni 2

Shoqëria "O2 BOUTIQUE" SHPK është person juridik shqiptar dhe si i tille do te ushtroje aktivitetin e saj tregtar, sipas ketij Statuti dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Neni 3

Kohëzgjatja e aktivitetit

Kohëzgjatja e aktivitetit te shoqërisë është fiksuar për një periudhe kohe te pakufizuar.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Shoqëria ka si objekt te veprimtarisë se saj:

- A- Siper marrjen ne fushen e sherbimit si bar,restorant dhe hoteleri.
- B- Tregtimin me shumice e pakice te gjithe artikujve industriale, pijeve alkolike dhe joalkolike
- C- Sherbime ne fushen e turizimit dhe snack-bar.

Neni 5



Për përmbushjen e objektit të veprimtarisë, shoqëria mund të marrë pjesë në ndërmarrje apo shoqëri të tjera që kanë objekt të njëjtte ose të përafërt me të sajën dhe mund të kryejë direkt apo indirekt të gjitha operacionet tregtare, financiare, me karakter të luajtshëm e të paluajtshëm.

Shoqëria mund të hapë dhe të mbajë llogari rrjedhëse në leke apo valuta të tjera, pranë bankave shqiptare apo të huaja, duke mundur gjithashtu të disponojë lirisht mjetet monetare të akumuluar në to, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6
SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë dhe Zyrat Qendrore të saj janë në adresën Lagja 3 Bulevardi Fan Noli Objekti 65 Ap 65. Asambleja ka kompetencën të hapë filiale e agjensi të tjera dhe t'i mbyllë ato, nëse e quan të nevojshme.

KREU II
KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTA
Neni 7

Kapitali themeltar i shoqërisë përbehet vetëm nga kontribute në para dhe është 100.000 (njëqindmijë) Leke. Ai është i ndarë në 2 (dy) kuota të cilat zotërohen nga ortakët themelues si më poshtë :

1. **Olson Blyku** zotëron 1(një) kuota të bazavlefishme me 50 (**pesëdhjete**)% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. **Oger Koleci** zotëron 1(një) kuota të bazavlefishme me 50 (**pesëdhjete**)% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortakët me kërkesë të Administratorit dhe në përputhje me dispozitat në fuqi të karakterit fiskal, kanë të drejtë të kryejnë pagesa apo të japin kontribute, në kapital, ose financime në favor të shoqërisë, të cilat konsiderohen financime pa interes. Shuma e financuar, afati i kthimit dhe menyra e rimbursimit të tyre rregullohen me kontratën përkatëse. Shumat e mësipërme mund të përdoren për të mbuluar humbjet ose transferohen direkt në rritjen e kapitalit në përputhje me vendimin e asamblesë së ortakëve.

KREU III
TRANSFERIMI I PJESEVE NOMINATIVE TË KAPITALIT THEMELTAR
Neni 8

Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme, ndërmjet ortakëve (me kontratë shitblerje ose dhurimi), ndërmjet bashkëshorteve (në rastin e ndarjes së pasurisë në bashkëpronësi familjare) dhe tek trashëgimtarët (në rast vdekje), dhe kalimi i tyre bëhet pa miratimin e asamblesë, (të ortakëve të tjerë).



Transferimi i pjesëve nominativë të kapitalit themeltar tek te tretet (persona fizike ose juridike jashtë bashkësisë së ortakëve) bëhet duke cëzuar fillimisht, të drejtën e parablerjes së ortakëve të tjerë, në përputhje me procedurën që vijon:

Ortaku që kërkon të transferojë kuotën e tij, tek te tretet, tërësisht apo pjesërisht, është i detyruar që fillimisht t'i rezervojë ortakëve të tjerë të drejtën e parablerjes. Për të mundësuar ushtrimin e kësaj të drejte, ortaku që dëshiron të transferojë kuotën e tij (ose një pjesë të saj) duhet të lajmërojë me shkrim (me letër-rekomandë) të gjithë ortakët që figurojnë në Statut (në adresën që rezulton në statut për secilin ortak), duke specifikuar çmimin e shitjes, mënyrën e pagesës dhe emrat e blerësve të mundshëm.

Çdo ortak i interesuar për blerjen e kuotes, duhet të përgjigjet ortakut ofertues, nepërmjet një njoftimi me shkrim, me të cilin deklaron se dëshiron të ushtrojë të drejtën e parablerjes për teresinë e të gjitha kuotave të ofruara (ose për një pjesë të tyre). Njoftimi duhet t'i dërgohet ortakut ofertues brenda 30 ditëve nga data e marrjes së ofertes, në të kundërt konsiderohet se është hequr dorë nga e drejta e parablerjes, dhe ortaku ofertues është i lire të transferojë kuotën tek te tretet, por jo me çmim më të ulët dhe me kushte më të favorshme se çmimi dhe kushtet që i ka ofruar ortakëve, në të kundërt shitja e kuotes tek te tretet konsiderohet e pavlefshme.

Nëse e drejta e parablerjes ushtrohet nga më shumë se një ortak, pjesëmarrja në oferte e secilit ortak do të jetë në përpjestim me kuotat që zoteron secilit prej tyre.

Nëse një ortak që gëzon të drejtën e parablerjes nuk mundet ose nuk dëshiron t'a ushtrojë atë, e drejta e ortakut që refuzon apo tërhiqet, (e drejta e parablerjes për këtë pjesë) i kalon ortakëve të tjerë në proporcion me kuotat që zoteron secili.

E drejta e parablerjes ushtrohet për çmimin e ofruar nga ofruesi.

Perjashtohet e drejta e parablerjes për rastet e pengut, por ortakët kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurat e ekzekutimit të detyrueshem apo të shitjes së kuotave të lena peng.

KREU IV
ASAMBLEJA
Neni 9

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimor i shoqërisë, që përfaqëson tërësinë e ortakëve.

Vendimet e saj merren në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me këtë Statut dhe janë të detyrueshme për të gjithë ortakët. Ato protokollohen në regjistër të veçantë në përputhje me ligjin.

Asambleja ka të drejtë të ushtrojë në çdo moment verifikime mbi Administratorin/et dhe të kontrollojë çdo dokument të shoqërisë. Ajo mund të urdhërojë apo të udhëzojë administratorin/et në kryerjen e detyrës së tij.

Asambleja ka këto kompetenca:

Vendos për përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë dhe strategjive të zhvillimit, përfshirë edhe investimet kapitale;
Vendos për ndryshimet e statutit;



Emeron dhe shkarkon Administratorin/et, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të Miratuar, si dhe përcakton shpërblimet e tyre;

Mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare nga Administratori/et, miraton buxhetin vjetor dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë;

Vendos për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

Vendos për pjesëtimin e kuotave dhe/ose anulimin e tyre;

Vendos për riorganizimin (shendrrimin, bashkimin me shoqëri të tjera, ndarjen), dhe/ose prishjen e shoqërisë;

Vendos për transferimin (blerjen, shitjen dhurimin, shkëmbimin) e pasurive të shoqërisë, për cedimin apo për dhenien me qira të shoqërisë ose degeve të saj, për dhenien me qira të aseteve të shoqërisë, për marrjen me qira të objekteve apo aseteve të ndryshme, për kontratat leasing, për pjesëmarrjen në kapitalin e kompanive të tjera nepermjet pjesëmarrjes në kapital, blerjes së kuotave apo aksioneve;

Vendos për miratimin e huamarrjeve me interes nga të tretet, si dhe për huamarrjet pa interes për vlera mbi 20.000 Euro (njetëmijë);

Vendos për dhenien e garancive hipotekore, pengut, barreve siguroese, dorezanise etj;

Miraton Bilancet, pasqyrat financiare dhe raportet e eksperteve kontabel të miratuar;

Miraton shpërdarjen e fitimit, nepermjet ndarjes së dividendeve ose vendos për kapitalizimin e tyre nepermjet zmadhimit të kapitalit;

Miraton strukturën organizative të shoqërisë, rregulloren e brendeshme dhe organogramen, rregulloren e sigurimit teknik, si dhe politikat dhe nivelin e pagave dhe shpërblimeve për çdo vend pune në shoqëri;

Vendos për çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji;

Neni 10 **Vendimarrja**

Vendimet e Asamblesë që merren me shumicë të zakonshme, janë të gjitha vendimet e Asamblesë për të cilat Ligji dhe Statuti nuk kërkojnë një shumicë të cilesuar.

Vendimet që merren me shumicë të zakonshme janë të vlefshme nëse në mbledhje janë të pranishëm ortakët (me të drejtë vote) që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kapitalit të shoqërisë (Kuorumi). Vendimi konsiderohet i marre nëse është vendosur me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës. Në rast se nuk arrihet Kuorumi i përcaktuar, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Për Vendimet e Asamblesë që merren me shumicë të cilesuar, mbledhja është e vlefshme nëse në mbledhje janë të pranishëm ortakët (me të drejtë vote) që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të kuotave (Kuorumi). Vendimi konsiderohet i marre nëse është vendosur me 75% (shtatëdhjetepesepërqind) të votave të ortakëve pjesëmarrës. Në rast se nuk arrihet Kuorumi i përcaktuar me sipër, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Merren me shumicë të cilesuar keto vendime:



Ndryshimi i Statutit;
Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
Riorganizimi (shndërrimi, bashkimi, ndarja) si dhe/ose prishja e shoqërisë,
Shperndarja e fitimeve ose kapitalizimi i tyre;
Percaktimi i politikës dhe mases së pagave dhe shperblimeve për çdo pozicion pune
në shoqëri, duke përfshirë edhe percaktimin e pages apo shperblimit të
Administratorit, ekspertit kontabel të miratuar dhe likuiduesve;

Asambleja e Përgjithshme me nismën e saj ose me kërkesën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar, mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

Nëse Asambleja e Përgjithshme, refuzon kërkesën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar, për nisjen e një hetimi të posaçëm ose nuk jep përgjigje brenda 60 ditëve atëherë, kërkuessit kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës.

Neni 11 **Zmadhimi i kapitalit themeltar**

Vendoset nga Asambleja me 75% (shtatëdhjetepesepërqind) të votave të ortakëve pjesëmarrës. Pas vendimit të asamblesë për zmadhimin e kapitalit, ortakët brenda 30 ditëve duhet të bëjnë derdhjet respektive, në proporcion me kuotën e kapitalit që zotëron secili.

Ortakët që kanë votuar kundër zmadhimit të kapitalit nuk janë të detyruar të kontribuojnë. Depozitimi i kapitalit të zmadhuar, behet vetëm nga ortakët që kanë votuar pro rritjes së kapitalit, secili sipas kuotës që është vendosur në asamble. Në mungesë marrëveshje për rindarjen e kuotave, barazohet me 100 (njëqind) shuma e kapitalit pas zmadhimit. Pas derdhjes së kontributeve të sipërpërmendura, Administratori/et duhet të regjistrojnë në librin e ortakëve zmadhimin e kapitalit, duke marrë nënshkrimin e atyre që kanë pranuar; si dhe të vazhdojnë me një përshkrim të ndarjes së kapitalit midis ortakëve.

Administratori/et me ligj dhe pa autorizim paraprak të Asamblesë, mund t'u kërkojnë llogari ortakëve që kanë nënshkruar zmadhimin e kapitalit, për derdhjen e kontributeve brenda afatit të sipërpërmendur.

Neni 12 **Zvogëlimi i kapitalit**

Vendoset nga Asambleja me 75% (shtatëdhjetepesepërqind) të votave të ortakëve pjesëmarrës.

Kur vendimi i zvogëlimit të kapitalit nuk motivohet nga humbjet në aktive, kreditorët e shoqërisë duhen njoftuar menjëherë; ata mund të kundërshtojnë vendimin pranë organeve gjyqësore.

Neni 13 **Transformimi**



Shndërrimi i shoqërisë në shoqëri anonime, bëhet mbas hartimit të raportit përkatës nga Administratori dhe miratimit nga Asambleja e Përgjithshme me një shumicë prej tre të katërtave, në përputhje me nenet 228 dhe 229 të Ligjit "Për Tregtarin dhe Shoqëritë Tregtare". Është i pavlefshëm çdo transformim i shoqërisë në kundërshtim me këtë dispozitë.

ADMINISTRIMI

Neni 14

Administrimi dhe përfaqësimi i shoqërisë i besohen një Administratori të Vetëm, që mund edhe edhe ortak në shoqëri. Administratori i vetëm emërohet për një periudhë prej 5 vjetesh me të drejte ripërtëritjeje, me përjashtim dorëheqje apo shkarkimi nga ana e Asamblesë.

Në detyrën e Administratorit emërohet: Z. Olgër Koleci i biri i Spiros, lindur në 08.05.1980, banues në adresën: Lagja 16 Rruga Viktor Efimiu, mbajtes i letërnjoftimit me nr. 100508073V.

Administratori gëzon kompetenca të pakufizuara për realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që Statuti ia njeh Asamblesë së Përgjithshme.

Në përmbushje të detyrës së tij, ai ka të drejte dhe detyrim të kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme; të përfaqësoj shoqërinë tregtare; të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; të përgatis dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të paraqesë këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim; të krijoj një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë; të kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit; të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.

Administratori kryen edhe detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut si edhe mund të vere në lëvizje instanca juridike dhe administrative, duke emëruar avokate e duke lëshuar prokurë në rastë gjyqesh, duke kryer operacione bankare, këtu përfshirë edhe hapjen e llogarive rrjedhëse, nënshkrimin dhe xhirimin e çeqeve, realizimin e tërheqjeve dhe derdhjeve me leke në dorë apo urdhër xhirimi, tituj krediti, paradhënie krediti.

Viti ekonomik fillon më 01 Janar deri më 31 Dhjetor çdo viti.

Neni 15

Administratori mund të emërojë përfaqësues, të cilëve, individualisht apo kolektivisht, mund t'u japë të drejtën e firmës, si dhe ato kompetenca, shpërblime e garanci që do të vlerësojë të arsyeshme. Ai mundet gjithashtu të emërojë drejtues ose përfaqësues për akte apo kategori aktesh të caktuar.

Neni 16
Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori (apo administratorët nëse do të emërohen të tilla) janë përgjegjëse individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqërisë ose të tretëve, për shkeljet ligjore të Statutit apo laje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Shoqëria nuk është përgjegjëse ndaj të tretëve, për aktivitete të kryera nga administratori në kundërshtim me kompetencat e tij, kur vërtetohet se ata ishin në dijeni të kësaj rrethane.

Administratori përgjigjet personalisht para shoqërisë dhe/ose të tretëve që kanë pësuar dëme nga ndonjë veprim i tij i paligjshëm.

Neni 17

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme, duke dhënë një motivacion. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorëve, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Administratori/ret mund të heq/in dorë në çdo kohë nga detyra e tij/tyre, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme. Administratori/ret, që jep dorëheqjen, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblesë të përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi. Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

PERFAQESIMI I PUNEMARRËSVE

Neni 18

Nëse shoqëria ka me shume se 50 punonjës atëherë ata kanë të drejtën të organizojnë një Këshill të punëmarrësve me një mandat 5-vjeçar me të drejte ripërtëritje ose kur shoqëria ka të punësuar me shume se 20 punëmarrës po me pak se 50 atëherë për çdo 10 punëmarrës zgjidhet një përfaqësues. Këshilli i Punëmarrësve apo përfaqësuesit e tyre gëzojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara nga neni 20 i Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

EKSPERTI KONTABELI AUTORIZUAR

Neni 19

Emërimi i ekspertit kontabël të autorizuar bëhet me vendim të asamblesë së përgjithshme e cila përcakton mandatin dhe shpërblimin.

Kur ligji e parashikon shprehimisht prezencën e ekspertit kontabël të autorizuar, janë të pavlefshme operacionet e kryera pa prezencën e tij.



Neni 20

Eksperti Kontabël i autorizuar pasi ka verifikuar librat kontabël, arkën dhe depozitat bankare, garanton që kontabiliteti vjetor është mbajtur në rregull, i korrespondon të vërtetës dhe është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Mund të shkarkohet nga funksionet e tij me vendim të asamblesë së përgjithshme si dhe me vendim gjykatë.

Eksperti Kontabël i autorizuar përpilon dhe i paraqet Asamblesë një raport financiar mbi ushtrimin vjetor që pasqyron situatën financiare në nisje dhe atë në mbyllje.

Kontrollon që bilanci përfundimtar dhe Raporti i përpiluar nga Administratori për Asamblesë, t'i korrespondojë realitetit.

Është i detyruar të paraqesë Administratorit dhe asamblesë së ortakeve:

a) Kontrollat, verifikimet dhe sondazhet e bëra ;

b) Zërat e bilanci dhe dokumentacionin kontabël që duhet korrigjuar duke sygjerruar edhe zgjidhjet;

c) Gabimet dhe pasaktësitë e konstatuara ;

d) Rezultatit financiar pas korrigjimeve të bëra;

Ai duhet të thirret në të gjitha mbledhjet e asamblesë së ortakeve ku aprohet bilanci i aktivitetit gjithë vjetor, por mund të thirret në të gjitha rastet kur konsiderohet e nevojshme.

Neni 21

Eksperti kontabël i autorizuar përgjigjet ndaj shoqërisë dhe ndaj të tretëve për pasojat e negative që rrjedhin nga gabime e neglizhime në kryerjen e funksionit të tij.

Nuk mban përgjegjësi për shkeljet ligjore të kryera nga administratori, me përjashtim të rasteve kur ka pasur dijeni për to, por nuk ia ka paraqitur dhe raportuar asamblesë.

KREU IV

FITIMET DHE FONDET

Neni 22

Fitimi që do të shpërndahet përbehet nga fitimet e realizuar gjatë vitit financiar të sapo mbyllur.

Asambleja mund të vendosë për formimin dhe shpërndarjen e fondeve të ndryshme.

Neni 23

Asambleja vetëm pasi ka miratuar bilancin përfundimtar dhe ka vendosur shumën që do të shpërndahet, përcakton pjesën e fitimit për ortakun e vetëm.

Shoqëria mund t'i shpërndajë fitime ortakut të vetëm, vetëm nëse administratori apo administratori, nën përgjegjësinë tyre personale, lëshojnë një certifikatë të aftësisë pagese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat nën 77 të Ligjit "Për Tregtarin dhe Shoqëritë Tregtare"



Gjate vitit, shoqëria ka te drejte t'i japë ortakut te vetem paradhënie mbi dividendët ne vlera jo me te mëdha se dividendi i shpërndarë një vit me pare, me kusht qe:

- a) Te mbetet e depozituar një rezerve, e barabarte me paradhëniet qe do te shpërndahen;
- b) Një Eksperti kontabël i autorizuar te vërtetoje ne një relacion me shkrim qe fitimet neto te realizuara deri ne atë moment janë me te mëdha se paradhëniet qe parashikohen për tu shpërndare ortakeve.

Shpërndarja e paradhënieve vendoset nga asambleja ose administratori. Ne vendimin përkatës duhet te specifikohen shumat dhe datat e kthimit.

Dividendët qe nuk korrespondojnë me fitimet e realizuara realisht, mund t'u reklamohen ortakeve qe i kane marre ato.

KREU V

PAVLEFSHMERIA E SHOQËRISË, PRISHIA, LIKUIDIMI DHE LARGIMI I ORTAKEVE

Neni 24

Pavlefshmeria absolute apo relative e themelimit të shoqërise, mund te konstatohen apo te shpallen vetem nese plotesohen nje apo disa nga kushtet e parashikuara ne nenin 3/1 te Ligjit Nr. 129/2014. Edhe pasojat e pavlefshmerise, do te zgjidhen ne perputhje me kerkesat e dispozites se cituar me siper.

Neni 25

Shoqëria mund te priset vetem ne keto raste:

- a) për çdo shkak të vendosur nga asambleja e përgjithshme e ortakëve;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaft-tueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- d) në rast se objekti bëhet i paralizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- dh) në rastet e pavlefshmerisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara ligj;
- e) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;

Neni 26

LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE

Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë pasi te njoftoje me shkrim për arsyet e largimit shoqërinë.

Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose



nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.

Ne këto raste zbatohen parashikimet e neneve 102, 103 dhe 104 të Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 27
LIKUIDIMI

Kur me vendim gjykatë shpallet pavlefshmëria absolute apo relative e shoqërisë si dhe në rastet e parashikuara në statut, asambleja e përgjithshme vendos prishjen e parakohshme të shoqërisë dhe fillojnë procedurat e likuidimit që do të kryhen sipas kërkesave të parashikuara në Ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe në përgjithësi nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

ORTAKET E SHOQËRISË "O2 BOUTIQUE" SHPK

Oljon Balyku


Olger Kolaci
